

Vendim nr. 320, datë 03.12.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryesuese
Ilir Toska, Anëtar
Marjana Semini, Anëtare

në datën 03.12.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 27 (E) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: EDIT SELIMI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 11930, datë 15.12.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1052, datë 04.05.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2025-1820, datë 14.05.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 71, 71/a, pika 1, shkronja b dhe 71/c, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në mars të vitit 2003 kërkuësja ka lidhur një kontratë shitjeje me një shoqëri për blerjen e një automjeti, me një çmim prej 12.500 eurosh. Palët kishin parashikuar shprehimisht në kontratë që mjete do të kishte disa përmirësime (opsione shtesë), krahasuar me variantin standard. Mjeti është marrë në dorëzim në datën 09.07.2003 nga kërkuësja dhe janë kryer pagesat me disa këste deri në vlerën 10.000 euro.

2. Në datën 07.02.2013 shoqëria ka paraqitur një kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke pretenduar detyrimin e të paditurës për të kryer pagesën e pjesës së mbetur të detyrimit prej 2.500 eurosh. Kërkuësja ka pretenduar se pagesa nuk ishte kryer në bazë të nenit 740 të Kodit Civil (KC), për shkak se mjete i marrë në dorëzim nuk ishte në përputhje me karakteristikat e parashikuara nga palët në kontratë. Për të mbështetur këtë pretendim, kërkuësja ka paraqitur edhe një vlerësim nga një ekspert në fushën e riparimit të automjeteve.

3. Nga ana tjetër, paditësja në atë gjykim ka pretenduar se kërkuësja ka marrë në dorëzim sendin, por nuk ka njoftuar asnjëherë shitësin për mangësitë sipas parashikimeve të bëra nga neni 9 i kontratës së lidhur ndërmjet palëve, sipas të cilit blerësi duhet të reklamojë me shkrim të metat, brenda 15 ditëve nga data e konstatimit, brenda afatit të kolaudimit dhe të garancisë.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 11930, datë 15.12.2014, ka vendosur pranimin e padisë, detyrimin e kërkuësës të paguante shumën e mbetur dhe ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për këtë vendim. Ajo gjykatë ka vlerësuar se kërkuësja (debitorja) nuk e ka përmbushur detyrimin e saj në afatin e caktuar dhe nuk ka njoftuar asnjëherë shitësin për mangësitë e mjetit, duke mbajtur të papaguar arbitrarisht një pjesë të detyrimit në një kohë që çdo detyrim i kërkuësës është parashkruar. Në lidhje me aktin e vlerësimit privat, ajo gjykatë ka vlerësuar se kërkuësja duhet të kishte paraqitur kundërpadi, për të cilën do të procedohej me kryerjen e një akti ekspertimi dhe se në këtë rast ai (akti i vlerësimit privat) nuk kishte vlerë provuese. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuësja.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1052, datë 04.05.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar, ndër të tjera, se në ankimin e paraqitur nga kërkuësja, (e paditura) nuk ekziston asnjë shkak ligjor që të bëjë të cenueshëm vendimin e asaj gjykate, pasi prej saj nuk është sjellë asnjë provë që të provojë se ka kryer pranë palës paditëse ndonjë reklamim të të metave të sendit sipas kushteve të kontratës së lidhur me të. Gjithashtu, ajo gjykatë është shprehur edhe për mosmarrjen parasysh nga gjykata e shkallës së parë të aktit të kryer nga eksperti teknik, duke e gjetur atë të bazuar, jo vetëm për faktin se palët në kontratë kanë parashikuar vetë mënyrën sesi do të bëhej reklamimi i të metave, por edhe sepse ato

nuk mund të verifikohen si kanë qenë, kur kanë kaluar rreth 13 vjet nga dorëzimi i sendit. Në përfundim, ajo gjykatë e ka vlerësuar të drejtë arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur rekurs.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1820, datë 14.05.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke arsyetuar se nuk plotësohen kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 427 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), si dhe pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të asaj gjykate.

7. Në datën 11.09.2025 kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 18.09.2025.

II

Pretendimet e kërkueses

8. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

8.1. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat nuk kanë thirrur një ekspert teknik, duke qenë se vlerësimi teknik i automjetit dhe sqarimi i fakteve kërkonte njohuri të veçanta teknike. Dokumenti “Vlerësimi i Karakteristikave të mjetit” i paraqitur nga kërkuesja është konsideruar si pa vlerë provuese, ndërkohë, që sipas nenit 247 të KPC-së, shkresat e thjeshta kanë vlerë të plotë provuese. Ky detyrim procedural nuk është përmbushur dhe nuk është konstatuar as nga gjykata e apelit. Gjykatat nuk kanë kryer një hetim të plotë të fakteve dhe të rrethanave të mosmarrëveshjes civile, por në mënyrë të njëanshme kanë shqyrtuar vetëm detyrimet e kërkueses pa konsideruar mospërmbushjen e detyrimeve të palës paditëse. Gjithashtu, kërkuesja ka pretenduar se pala paditëse asnjëherë nuk ka lëshuar prokurë të rregullt sipas nenit 72 të KC-së dhe në këtë mënyrë duhet të konsiderohej në mungesë, për rrjedhojë çështja duhet të ishte pushuar nga gjykata. Të gjitha këto shkelje serioze nuk janë marrë në konsideratë as nga Gjykata e Lartë. Nga ana tjetër, ajo gjykatë është mbështetur edhe në argumentin se nuk mund të bëjë një rivlerësim të provave të kundërt me atë të bërë nga gjykatat e faktit. Çështja që

është shtruar nuk është vlerësimi i provës, por refuzimi i gjykatave më të ulëta që të marrin provën me ekspert, detyrim ligjor ky që buron nga neni 224/a i KPC-së. Po kështu, ato gjykata nuk e kanë konsideruar provën e sjellë nga kërkuesja si akt ekspertimi privat, duke shkelur rëndë dispozitat e KPC-së që u njeh fuqi provuese akteve private.

8.2. *Së drejtës për t'u mbrojtur*, pasi gjykata e apelit ka refuzuar kërkesën e paraqitur nga avokati i kërkueses për shtyrje të seancës, duke i mohuar asaj mundësinë që të mbrohej në një proces të rregullt gjyqësor.

8.3. *Parimit të barazisë së armëve*, pasi gjykata e apelit ka zhvilluar seancën në një kohë rekord prej 7 minutash dhe pas një shqyrtimi sipërfaqësor është shprehur me vendim përfundimtar.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në verifikim të plotësimin të këtyre kriterëve, në rastin konkret, Kolegji çmon se kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në proceset gjyqësore, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe si bartëse e të drejtave të pretenduara të cenuara ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Në lidhje me *kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vlerëson se kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me

ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë, mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta.

12. Kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi Kolegji konstaton se vendimi më i fundit gjyqësor i dhënë në çështjen e saj është ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që mban datën 14.05.2025, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 11.09.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

13. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, ai ka të bëjë me përmbajtjen dhe natyrën e pretendimeve të parashtruara nga individi në ankimin kushtetues individual. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave kushtetuese. Mënyra sesi gjykatat e zakonshme kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (*shih vendimet nr. 5, datë 29.01.2025; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrë e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se pavarësisht se pretendimet kërkuesja i ka parashtruar në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, ajo, në thelb, ka ngritur pretendime për mënyrën e interpretimit të dispozitave të ndryshme të KPC-së dhe të KC-së nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Sipas kërkueses, në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk kanë kryer akt ekspertimi për konstatimin dhe sqarimin e fakteve që kanë lidhje me mosmarrëveshjen sipas nenit 224/a të KPC-së. Gjithashtu, sipas saj, ato gjykata nuk kanë marrë parasysh nenin 485 të KC-së për pezullimin e zbatimit të detyrimit, nenet 715, 716, 722, dhe 723 të tij për cilësinë dhe mangësitë e sendit dhe nenin 740 për pezullimin e përmbushjes së detyrimeve në favor të kërkueses, pavarësisht se këto dispozita

përcaktojnë përgjegjësinë e palëve, si dhe njohin të drejtën e njëres palë që të kërkojë ulje çmimi ose të mos përmbushë detyrimet e saj nëse pala tjetër nuk i ka përmbushur rregullisht detyrimet që i takojnë. Gjykatat e zakonshme gjithashtu nuk janë shprehur në lidhje me nenin 72 të KC-së për përfaqësimin me prokurë me akt noterial të palës paditëse. Po kështu, ajo pretendon se i është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe e drejta për t'u mbrojtur, pasi seanca gjyqësore në gjykatën e apelit është zhvilluar për një kohë shumë të shkurtër dhe nuk është marrë parasysh kërkesa e saj për shtyrje.

15. Lidhur me pretendimin e kërkueses se gjykatat e zakonshme nuk janë shprehur për përfaqësimin e paditëses në gjykim, Gjykata vëren se edhe pse gjykatat e zakonshme nuk kanë arsyetuar në mënyrë të shprehur për përfaqësimin e saj, argumenti i sjellë nga kërkuësja për kryerjen e këtij veprimit juridik me prokurë (sipas nenit 72 të KC-së) nuk rezulton se gjen zbatim në rastin konkret, prandaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

16. Gjithashtu, Kolegji vëren se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka vlerësuar si të pasaktë interpretimin e kërkueses për pezullimin e pagesës së plotë të çmimit mbi bazën e neneve 740 dhe 485 të KC-së, pasi në kontratë palët kanë parashikuar detyrimin e blerësit për të njoftuar me shkrim për mangësitë e sendit, brenda 15 ditëve nga konstatimi i metave. Gjatë atij gjykimi, nuk është paraqitur asnjë provë që të jetë bërë një njoftim i tillë nga ana e kërkueses (blerëses). Ajo gjykatë është shprehur edhe për aktin e vlerësimit privat mbi karakteristikat e mjetit, duke e konsideruar se nuk ka vlerë provuese për pretendimet e saj. Në këtë mënyrë ajo gjykatë e ka konsideruar me vonesë kërkuesen në kuptim të nenit 481 të KC-së, si dhe ka arsyetuar se nenet 476 dhe 698 të KC-së kanë parashikuar mundësi ligjore për të mbrojtur interesat e saj në drejtim të përmbushjes së detyrimit ose të shpërblimit të dëmit të shkaktuar. Ky arsyetim është vlerësuar si i drejtë nga gjykata e apelit, e cila e ka konsideruar të pabazuar edhe pretendimin e kërkueses për mosmarrjen parasysh të aktit të ekspertit teknik, pasi palët kishin parashikuar në kontratë mënyrën e reklamimit të të metave.

17. Në lidhje me gjykimin në gjykatën e apelit, kërkuësja ka pretenduar se asaj i është cenuar edhe parimi i barazisë së armëve dhe e drejta për t'u mbrojtur, pasi ajo gjykatë ka zhvilluar seancën në një kohë prej 7 minutash, si dhe ka refuzuar një kërkesë për shtyrje të paraqitur nga ajo. Nga dëgjimi i regjistrimit audio të seancës, për efekt të këtij gjykimi kushtetues, rezulton se seanca ka nisur në kohën e caktuar, por përfaqësuesi i kërkueses është paraqitur me vonesë në seancë, si dhe ka paraqitur kërkesë për shtyrje, pasi gjykata ishte tërhequr për vendimmarrje dhe ishte rikthyer për të shpallur vendimin. Nga regjistrimi rezulton gjithashtu se përpara tërheqjes për

vendimmarrje, gjykata kishte kryer veprimet përgatitore, kishte bërë relatimin, si dhe kishte dëgjuar palën paditëse e cila kishte paraqitur pretendimet e plota me shkrim. Bazuar në këto fakte, Kolegji çmon se ky pretendim i kërkueses është haptazi i pabazuar.

18. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se në rekurs nuk janë paraqitur shkaqe ligjore nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së, të cilat mund të bënin të cenueshëm vendimin e gjykatave më të ulëta, duke konstatuar, ndër të tjera, se nga ana e gjykatave të faktit janë respektuar normat procedurale; palëve u është dhënë mundësia të realizojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes, të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare, të debatojnë për to, të shprehin qëndrimin e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjes; janë respektuar dhe zbatuar drejt dispozitat e ligjit material; është bërë një cilësim i drejtë i fakteve dhe i rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen, është kryer një analizë juridike e plotë e provave dhe e kanë zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se gjykatat e faktit kanë përmbushur detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre, ndërkohë që interpretimi i ligjit nga ato, i shprehur përmes arsyetimit të vendimit, nuk duket të jetë i paarsyeshëm ose eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë, të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, bazuar në standardet kushtetuese të lartpërmendura, pretendimet e ngritura nga kërkuësja për cenimin e gjykimit të drejtë të lidhur me standardin e arsyetimit, së drejtës për t'u mbrojtur dhe parimit të barazisë së armëve, janë haptazi të pabazuara.

19. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.